



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.2.2025

Nr: 118

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË MINISTRISË SË
TURIZMIT DHE MJEDISIT, PËR PERIUdhËN 09 SHKURT-15 SHKURT 2025**

Sot, më datë 20.2.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

SUBJEKT: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për periudhën 09 shkurt-15 shkurt 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 09 shkurt-15 shkurt 2025, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- "Panairi i Turizmit", raportuar në datë 10.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 12.02.2025.

Nëpërmjet postës elektronike, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Data: 20.2.2025 Nr. 118
Ora:13:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për periudhën 09 shkurt-15 shkurt 2025”

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Lidhur me raportimin e aktivitetit që do të zhvillohej më 12-13 Shkurt 2025, në Pallatin e Kongreseve, Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT) ka qenë pjesëmarrëse në Panairin e Turizmit "Tourism and Travel Show Albania". Ky panair është organizuar nga Kompania Iceberg Exhibitions dhe mosraportimi në kohë nga ana jonë ka ardhur si pasojë e një mosrakordimi të brendshëm, duke menduar se nuk hynte tek aktivitete për të cilat institucioni ka detyrimin për të raportuar”*.

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstatova se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka patur mundësi të raportoje në kohë për këtë aktivitet për shkak se ka qenë në cilësinë e të ftuarit.

Për sa më sipër, referuar pikës 3, të nenit 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, veprimtaritë ku institucioni publik apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë, nuk mbartin detyrimin për t'u raportuar

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI